

## Akt-Themelimi

### I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

#### Vega Invest Shpk

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Vega Invest**” Shpk, e përbërë nga:

1. **Suela Ereqi**, e bija e Skender dhe Luljeta, lindur më 21/04/1995 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: Rruga “Ndre Mjeda”, Ap.2116, Tiranë, me kombësi Shqiptare me nr.personal J55421077Q në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.34%** të kapitalit të shoqërisë.
2. **Seldi Sulejmani**, i biri i Niazi dhe Arjana, i lindur më 01/02/1998 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: “Rruga e Dibrës”, Tiranë, me nr.personal J80201055L në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.33%** të kapitalit të shoqërisë.
3. **Skender Hoxhaj**, i biri i Namik dhe Dhurata, i lindur më 10/10/1994 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: Fier, Riza Hoxha, Nd.17; H.1, Qendër; Drizë; 9322; me nr.personal J41010122J në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.33%** të kapitalit të shoqërisë.

Në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit Shqiptar, vendosen të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “**Vega Invest**” Shpk mbi bazën e këtyre principeve:

#### Neni 1

##### Emri dhe Forma

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**Vega Invest**” (Shoqëria), ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “sh.p.k”, i cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

#### Neni 2

##### Baza Ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

#### Neni 3

##### Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Fier, Rruga L”Sheq i Madh”, Nr. Pasurie 155/48, Ndërtesë dy katëshe, Zona kadastrale Nr. 3981**. Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo dhe brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

#### **Neni 4 Kohëzgjatja dhe Prishja e Shoqërisë**

- 4.1** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent.
- 4.2** Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar.

#### **Neni 5 Objekti i Veprimtarisë**

- 5.1** Shoqëria “**Vega Invest**” Shpk është e fokusuar në Investimin në instrumente financiare (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërive Tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, burimeve njerezore etj.) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë.

#### **Neni 6 Kapitali Themeltar dhe ndarja e tij**

- 6.1** Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total **150,000** (Njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota me vlerë 50,000 lekë secila.
- 6.2** Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

- **Suela Ereqi**, e bija e Skender dhe Luljeta, lindur më 21/04/1995 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: Rruga “Ndre Mjeda”, Ap.2116, Tiranë, me kombësi Shqiptare me nr.personal J55421077Q në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.34%** të kapitalit të shoqërisë.
- **Seldi Sulejmani**, i biri i Niazi dhe Arjana, i lindur më 01/02/1998 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: “Rruga e Dibrës”, Tiranë, me nr.personal J80201055L në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.33%** të kapitalit të shoqërisë.
- **Skender Hoxhaj**, i biri i Namik dhe Dhurata, i lindur më 10/10/1994 në Fier, Shqipëri dhe banues në adresën: Fier, Riza Hoxha, Nd.17; H.1, Qendër; Drizë; 9322; me nr.personal J41010122J në cilësinë e ortakut të shoqërisë, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **50,000** (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **33.33%** të kapitalit të shoqërisë.

**Neni 7**  
**Aktet e Shoqërisë**

7.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Organet Drejtuese**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 8.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorët e Shoqërisë “Vega Invest” Shpk, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.
- 8.3 Administratori i shoqërisë **Z.Seldi Sulejmani** është emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Në rast se në vijim do të emërohen administratorë të tjerë ata mund t’i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht ose veç e veç.

**Neni 9**  
**Dispozitat e Fundit**

- 9.1 Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.
- 9.2 Ky Akt-themelimi është hartuar me 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën Shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, 10/10/2023

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**VEGA INVEST SHPK**

Suela EREQI

*Suela Ereqi*

Seldi SULEJMANI

*Seldi Sulejmani*

Skender HOXHAI

*Skender Hoxhaj*

*[Signature]*  
*[Signature]*

*[Signature]*